

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

13.04.2022  
Ora 12:36

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Durrës”.*

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu)**
- **Bashkia Durrës:**      **(A. Isaku)**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë fillojmë seancën publike, e cila sot në rendin e ditës ka katër çështje.

Ka projektvendimin “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të subjekteve zgjedhore, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, për shkelje të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator nga Bashkia Durrës”.

Pika e dytë. Projektvendimi “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të bërë nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike në lidhje me shkelje të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi i Rregullatorit, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator për Bashkinë e Rrogozhinës”.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

Pika e tretë. Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, për autoritetin portual Durrës”.

Pika e katërt, projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, po të organizatës “Qëndresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, si dhe shkelje të tjera të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, ndaj drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Armath” dhe kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Durrës, propozuar nga Partia Socialiste”. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që në fakt është vazhdim i seancës së zhvilluar përpara disa kohëve, në lidhje me ankimin e bërë nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, në lidhje me disa vendimmarrje të Bashkisë Durrës. E shtymë seancën e kaluar. Në seancën e kalur vendosëm për t’i kërkuar Bashkisë Durrës për të dhënë një informacion më të detajuar në lidhje me vendimmarrjet e këshillit bashkiak, në lidhje me trajtimin e disa qytetarëve me fondet nga rindërtimi, dhe vendimmarrjen tjetër po të këshillit bashkiak që lidhet me parazgjedhore, parazgjedhjet e 6 marsit. Dokumentacioni është depozituar?

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Po, i nderuar! Dokumentacioni është depozituar brenda tri ditëve, siç u la në seancë. Ne i kemi paraqitur edhe me postë dhe me e-mail. Lidhur me informacionin që është kërkuar për numrin e qytetarëve që kanë të drejtë vote, përgjigjja jonë lidhur me 526, pra, me vendimin e këshillit bashkiak, është e datës 18.03.2022, me numër protokolli 2350/3. Duhet ta citoj?

**Z. I. Celibashi:** Si të doni!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Atëherë, lidhur me vendimin e këshillit bashkiak nr. 11, datë 28.01.2022 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare sipas listës së 13, me subjektet përfituese të programit të grantit, për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit e datës 26 nëntor, për banesat e dëmtuara, numri i këtyre qytetarëve që kanë pasur të drejtë vote është 1226. Kërkesa tjetër ishte lidhur me ndihmën ekonomike. Disa sqarime për procedurën në seancën e kaluar thamë që ndihma ekonomike është çdo muaj, pra është e përmuajshme dhe nuk ka lidhje, nuk mund të mos jepet nga këshilli bashkiak.

**Z. I. Celibashi:** Pa i rëpërsëritur ato çfarë kemi thënë, thjesht, vetëm nëse keni sqarime, komente, mbi ato çfarë dokumentet e reja, dokumentacioni i ri që paraqitet, vetëm kaq.

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Në lidhje me dokumentacionin e ri ne kemi paraqitur dhe vendimin e këshillit bashkiak të dhjetorit, dhe të janarit, dhe të shkurtit, për të pasur një ide lidhur me personat që përfitojnë ndihmën ekonomike në Bashkinë Durrës. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Besoj dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike është njohur me dokumentacionin e paraqitur. Një koment të fundit mbi këtë dokumentacion të paraqitur dhe për të vazhduar më tej. Po zoti Logu, vazhdojmë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Mbi dokumentacionin nuk kemi ndonjë koment shumë të zgjeruar zoti Komisioner, përveçse faktit që është provuar ajo që ne kemi thënë. Pra, që më datën 28 janar është shpërndarë ndihma ekonomike për të paktën

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

89 familje. Ndërkohë që në datën 25 shkurt kemi pasur një tjetër vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Durrës për shpërndarjen e ndihmës ekonomike për 90 familje. Ne besojmë që Kodi Zgjedhor është shumë i qartë, ashtu siç është dhe vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, sa i përket faktit, në qoftë se mundet, qofshin këto organet e pushtetit qendror apo pushtetit vendor, të nxjerrin akte ligjore apo nënligjore që sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore. Kështu që sa i përket këtij dokumentacioni besojmë që është në harmoni me të gjitha pretendimet që ne kemi parashtruar përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Nëse nuk kemi kërkesa për dokumentacion shtesë, apo prova të tjera, do të propozoja që ta mbyllim si hetim administrativ dhe për të kaluar tek pretendimet përfundimtare. Nuk kemi? Mirë, atëherë e mbyllim hetimin administrativ. Fjalën palëve për pretendimet e tyre të fundit. Fillimisht përfaqësuesit të Partisë Demokratike, zotit Logu, pretendimet përfundimtare në lidhje me kërkimet nga ana e subjektit tuaj dhe pastaj përfaqësuesit të Bashkisë Durrës, faleminderit!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Komisioner! Ne kemi qenë shumë të zëshëm dhe të vëmendshëm edhe gjatë procesit zgjedhor të 25 prillit, i cili për pak ditë bëhet një vit nga ai proces, lidhur me faktin që organe të pushtetit qendror, por edhe të pushtetit vendor, përfshirë këtu edhe Bashkinë Durrës, përdornin fondet publike, paratë e taksapaguesve shqiptarë, në mënyrë që të manipulonin, apo të devijonin vullnetin e zgjedhësve, dhe kjo sigurisht që materializoi nëpërmjet disa vendimeve të vetë bashkisë, apo organeve të saj, siç është rasti i këshillit bashkiak. Jo më kot në atë proces zgjedhor ne kemi pasur mundësi të sjellim fakte dhe prova sesi vetëm një javë përpara datës së zgjedhjeve u


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

shpërndanë rreth 6 milionë euro fonde dhe grante për rindërtimin. Pretendimi jonë, i nderuar, në këtë proces, i cili është ngritur që në datën 2 shkurt, ka pasur të bëjë me faktin se ne kemi siguruar disa informacione nëpërmjet mediave që Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës është mbledhur në datën 28 janar dhe ka vendosur të shpërndajë një fond për rindërtimin për 526 familje, të cilat sipas shkresës së përcjellë nga vetë Bashkia Durrës, drejtoria ligjore në datën 18.03.2022, ka prekur dhe ka afektuar të paktën 1226 votues. Pra, numrat realisht janë të konsiderueshëm, ashtu siç është i konsiderueshëm edhe fondi i shpërndarë, ose fondi i akorduar, i cili do t'u shpërndahet këtyre personave, familjeve, në një procedurë të mëvonshme, prej rreth 3 milionë euro. Sigurisht që në vlerësimin tonë këto nuk janë vendimmarrje as të rastësishme, as rutinore, por bëhen me qëllime të qarta për të manipuluar dhe devijuar vullnetin e zgjedhësve. Kjo është arsyeja zoti Komisioner, pse në fakt në rendin e ditës u është dërguar anëtarëve të Këshillit Bashkiak Durrës, në datën 24 janar nuk përmenden në asnjë pikë vendimmarrje të këshillit bashkiak që kanë të bëjnë me shpërndarjen e fondeve të rindërtimit. Vetëm dy ditë përpara mbledhjes së këshillit bashkiak, në datën 26 janar është vendosur të shtohet një pikë që kishte të bënte me akordimin e këtyre fondeve. Në vlerësimin tonë jemi në një rast tipik të qartë dhe të pastër, të ndalimeve që ka pasur parasysh legjislatori, me nenin 91, pika 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisjes së re, në këtë rast jemi për zgjedhjet vendore, ndalohet propozimi, miratimi, ose nxjerrja e akteve ligjore, ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënie përfitime për kategori të caktuara të popullsisë, dhe kemi të bëjmë më 526 familje, apo me 1226 votues, sipas informacionit të sjellë zyrtarisht nga Bashkia Durrës. Duke mos u ndalur vetëm në këtë pikë, rezulton në fakt që po në këtë datë, po në datën 28 janar ka pasur një vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Durrës për të shpërndarë ndihmën ekonomike dhe për 89 familje, sipas vetë vendimeve dhe akteve të sjella nga Bashkia Durrës, të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

cilat besoj dhe përfaqësuesi i bashkisë Durrës pati mundësi t'i relatojë pak më herët. Pra, është vendimi nr. 7, datë 28 janar 2022, por veçmas këtij, i nderuar, sepse ka një pretendim, i cili besoj do ndalemi edhe pastaj, ka një vendimmarrje sërish të datës 25.02.2022, jemi vetëm 9 ditë, apo 8 ditë përpara datës së zgjedhjeve ku Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës ka akorduar ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 90 familje, ka shtuar 6 familje të tjera në skemën e ndihmës ekonomike, dhe nga ana tjetër thotë që "përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar dhe 20 familje me një fond të caktuar", dhe janë edhe emrat, mbiemrat e personave. Pra, kemi të bëjmë qartazi me një numër të konsiderueshëm familjesh që futen për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike. Akt nënligjor që sjell përfitime për kategori të caktuara të popullsisë, është vendimi i marrë në datën 25 shkurt 2022 nga ana e Bashkisë Durrës, vendimi nr. 13, i cili po ashtu është pjesë e ankimit tonë. Kështu që duke mos dashur, i nderuar, t'i kthehemi të gjithë atyre pretendimeve dhe sqarimeve, shpjegimeve që ne kemi bërë tashmë në seancën e mëparshme, mos gabofsha, të datës 16.03.2022, pasi kemi qenë shterues dhe ezaurues, ne vlerësojmë se vendimmarrjet, dy vendime që kanë të bëjnë me shpërndarjen e fondeve të rindërtimit për 526 familje, dhe shpërndarjen e ndihmës ekonomike për 89 familje, në datën 28 janar 2022, dhe vendimmarrja e datës 25 shkurt 2022, janë raste tipike, flagrante sesi Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës me paratë e taksapaguesve, me paratë e buxhetit të shtetit, ka kërkuar në prag të zgjedhjeve, në një rast vetëm 8 ditë përpara zgjedhjeve, të manipulojë, të tjetërsojë dhe të devijojë vullnetin e tyre. Ky në fakt ka qenë një konstatim jo vetëm i raportit të OSBE/ODIHR-it, por besoj meqenëse është publikuar këto ditë, është një konstatim i përsëritur edhe i raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, që flet qartazi sesi pushteti vendor, apo qendror, përdor fondet publike për të krijuar avantazhe elektorale në proceset zgjedhore. Kështu që përfundimisht, i nderuar, ne

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

kërkojmë që denoncimi ynë të pranohet, dhe të merren masat në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe me atë çka i dikton vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator ndaj Bashkisë Durrës. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Logu! Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës!

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** I nderuar, unë i kam sjellë me shkrim pretendimet e mia.

**Z. I. Celibashi:** Po, mund t'i depozitoni nëse doni t'i prezantoni përmbledhtazi, mundet ta bëni.

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Po, në rregull! Përmbledhtazi Bashkia Durrës nuk ka shkelur Kodin Zgjedhor dhe as vendimin që citohet nga organi denoncues. Ne e sqaruar dhe në seancën e kaluar, por dhe me dokumentet shkresore që çdo vendim i këshillit bashkiak është marrë në përputhje me ligjin. Kemi pasur në brendësi të këtyre vendimeve elemente të emergjencës që përjashtohen nga rastet që u cituan këtu nga parafolësi. Përfundimisht ne kërkojmë që edhe lidhur me vendimin që lidhet me ndihmën ekonomike, është një vendim që ne duhet ta marrim patjetër sepse është i përcaktuar në ligj dhe në datën 15 të çdo muaji, lista e këtyre përfituesve i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Kështu që këto janë detyrime ligjore të cilat nuk kanë lidhje fare me pjesën e fushatës zgjedhore. Në konkluzion ne kërkojmë që të pushohet, të mos pranohet denoncimi i palës ankimuese.


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, i japim fund shqyrtimit administrativ në lidhje me kërkesën e paraqitur nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim në lidhje me shkeljet e pretenduara, të kryera nga ana e Bashkisë Durrës. Vendimin do ta shpallim në një ditë të javës tjetër, të cilën do t'ua njoftojmë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

13.04.2022  
Ora 12:52

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Rrogozhinë”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu)**
- **Bashkia Rrogozhinë:**      **(E. Kacani)**


**Z. I. Celibashi:** Atëherë, kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me ankimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike mbi veprimtari të Bashkisë Rrogozhinë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për procedurë në qoftë se mundem, i nderuar?

**Z. I. Celibashi:** Po!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Unë në fakt kam pritur të njihem me materialin e kërkuar nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, më është vënë në dispozicion vetëm ditën e sotme, jo nga KQZ-ja, ç’është e vërteta. Dje pranë zyrave të Partisë Demokratike, në selinë e Partisë Demokratike ka ardhur një zarf, i cili ka praktikën e plotë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 13.04.2022*

shkresore të dërguar në datën, shkresa mban datën 25 mars, por është sjellë pranë KQZ-së në datën 30 mars. Ne kemi pasur mundësi, ka mbërritur vetëm ditën e djeshme në selinë e Partisë Demokratike, unë jam njohur vetëm sot, tani bile, ma solli asistentja pak më herët. Kështu që do kërkoja me mirëkuptimin tuaj që të na jepej koha e mjaftueshme që të njiheshim me këtë material sepse e kam të pamundur, duke qenë se është edhe pak voluminuz, që të njihem me tërësinë e materialit dhe më pas të bëj edhe konkluzionet mbi këtë material.

**Z. I. Celibashi:** Po, patjetër, pranohet kërkesa juaj dhe do ta shtyjmë seancën dhe do t'ju njoftojmë zyrtarisht mbi datën dhe orën e seancës. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

13.04.2022  
Ora 12:53

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Autoritetit Portual Durrës”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**
- **Të tjerë:**
  1. Organizata Qëndresa Qytetare: **Znj. T. Kurti, R. Xhemollari**
  2. Autoriteti Portual Durrës **Z. A. Marku**
  3. Bashkia Durrës **Z. A. Isaku**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e tretë dhe të katërt të rendit të ditës. Pika e tretë ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj Autoritetit Portual Durrës. Përfaqësuesit e organizatës i shoh që janë prezent. Nga Autoriteti Portual Durrës, ka prezent?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Hapim seancën për shqyrtimin e kësaj çështjeje, ju lutem prezantimi nga përfaqësuesi i Organizatës Qëndresa Qytetare?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Përhëndetje, unë jam Teisa Kurti, përfaqësuese e Qëndresës Qytetare në këtë proces, me anë të autorizimit të cilin do ta depozitoj në vijim. Gjithashtu gjej rastin që në këtë seancë të depozitoj dhe prapësimet tona lidhur me këtë çështje, por do të ndalem edhe shkurtimisht mbi to.


**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Faleminderit! Përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës? Emër, mbiemër ju lutem dhe aktin e përfaqësimit!

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Jam Aleks Marku, Drejtor i Divizionit Juridik të Autoritetit Portual Durrës. Përfaqësoj autoritetin sipas autorizimit nr. 1410, datë 13.04.2022.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! I japim fjalën fillimisht përfaqësuesit të Organizatës Qëndresa Qytetare për të prezantuar kërkesën dhe pretendimet tuaja në lidhje me shkeljet sipas jush të evidentuara, shkelje të Autoritetit Portual Durrës. Pastaj do t'i jap fjalën përfaqësuesit të Autoritetit Portual Durrës për të vendosur bazuar në çfarë do të prezantojë secila prej palëve, për ecurinë e mëtejshme të procesit.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Faleminderit zoti Komisioner! Ashtu siç kemi raportuar në denoncimin nr. 3592 të ID, Qëndresa Qytetare ka raportuar aktivitetin e zhvilluar në datë 12.02.2022 në ambjentet e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

Autoritetit Portual Durrës, me praninë e drejtorit të Autoritetit Portual Durrës, të zotit Klevis Hysa, i cili është drejtor i Agjensisë së Punësimit dhe Aftësimit dhe zonzjës Emiriana Sako e cila asokohe ishte dhe kandidatë për kryetare të Bashkisë Durrës, si dhe rektoria e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës. Nga sa shihet dhe nga faktet që ne kemi depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në këtë aktivitet është bërë shpallja e programit të specializimit dhe praktikave profesionale në fushën e administrimit portual. Në këtë aktivitet gjithashtu kanë qenë të ftuar studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe persona të tjerë siç shihet edhe nga fotot. Pra, ka qenë një aktivitet me një pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe personave të tjerë. Lidhur me sa jemi njohur dhe me përgjigjet e kthyer nga palët, të cilat na janë vënë në dispozicion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga palët pretendohet se ky aktivitet nuk ka qenë një aktivitet publik. Vetë karakteri i këtij aktiviteti është publik, sepse synon shpalljen e një thirrje të gjerë për personat e interesuar. Target grupi në këtë rast janë studentët. Po ashtu siç shihet dhe në ftesën që na është vënë në dispozicion nga provat e administruara, thuhet shprehimisht që “Ju ftojmë në aktivitetin e thirrjes publike”. Pra, edhe një fakt tjetër i cili provon se ky aktivitet është një aktivitet me karakter publik, i cili në kushtet e nenit 92, pika 1 do të duhej të ishte raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi përveçse ka një karakter publik, ai synon të informojë të interesuarit mbi një axhendë. Po ashtu, në qoftë se i refrohemi përgjigjeve të kthyer nga institucionet palë të këtij procesi, thuhet se është një aktivitet në kuadër të një plani vjetor i cili rakordohet ndërmjet Autoritetit Portual dhe Qendrës së Ekselencës. Nisur nga këto fakte, unë do të doja të shtroja disa pyetje për diskutim, në qoftë se më lejoni?! Duke qenë se flitet për një plan vjetor, kur saktësisht ishte planifikuar çelja e kësaj thirrje dhe pse pikërisht ky aktivitet vjen në një periudhë kohe që është pas shpalljes së Dekretit të Presidentit për zgjedhjet e pjesshme vendore? Në kushte të tjera vihet re

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

gjithashtu se ftesa në këtë aktivitet i është drejtuar personalisht me e-mail zonjës Emirjana Sako, për të qenë pjesëmarrëse në këtë aktivitet, në kuadër edhe të projekteve të bashkisë. Besoj se zonja Emirjana Sako nuk është përfaqësuesja e vetme e bashkisë dhe ndoshta në këtë rast nuk do të kishte qenë e nevojshme ftesa personale. Theksoj se gjendeshim në kohën e periudhës zgjedhore, ku tashmë kandidatët ishin shpallur dhe do të mbaheshin zgjedhjet e pjesshme. Nisur nga ky fakt, kur ky aktivitet vjen në një kuadër të disa aktiviteteve të tjera elektorale të zonjës Sako, shihet se prezenca e saj në këtë aktivitet i ka dhënë asaj mundësinë që të shprehet për një premtim të ardhshëm për kartat e studentit. Siç shihet edhe nga provat që ne kemi depozituar, në profilin e saj personal, ajo thotë që “më është dhënë mundësia t’u bëj të ditur që vitin e ardhshëm të gjithë studentëve do t’i bëhet e mundur të kenë kartat e tyre të studentit”. Duke i dhënë zonjës Emirjana Sako hapësirën e mundëshme për të bërë një premtim të karakterit politik. Po ashtu nga palët është mohuar karakteri politik dhe publik i këtij aktiviteti, por në fakt i gjithë kuadri i aktivitetit dhe vetë thirrja për këtë program, ka një karakter politik, pasi synon të nxisë pjesëmarrjen, rritjen e aftësive profesionale dhe praktike të studentëve që më vonë nxisin punësimin e tyre. Për sa më sipër, ne kërkojmë “konstatimin e shkeljeve”, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve, bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit! Përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës!

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Përshëndetje të gjithëve! I nderuar zoti Kryetar, Autoriteti Portual Durrës i ka paraqitur shpjegimet e tij për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me aktivitetin që është bërë objekt denoncimi. Ashtu siç e kemi pranuar, ka qenë një aktivitet i karakterit teknik mes

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

partnerëve të Qendrës së Trajnimit, pranë Autoritetit Portual Durrës. Takimi ka qenë mes partnerëve pra, sikurse dhe universiteti i Durrësit ka paraqitur memorandumit e bashkëpunimit. Takimi ka qenë mes partnerëve dhe përfaqësues të institucioneve që mbulojnë veprimtarinë në fushën detare. Thirrja, apo njoftimi të cilit i referohet pala denoncuese është ftesë e drejtuar partnerëve dhe nuk është një ftesë e bërë publike për pjesëmarrje në atë aktivitet. Pra, nuk ka karakter publik aktiviteti. Nuk ka pas prani të mediave, nuk ka pas ftesa për mediatizim të këtij aktiviteti. Në këto kushte, ashtu sikurse dhe e kemi shpjeguar, ne e kemi vlerësuar si një aktivitet jo publik, jo mediatik, por të karakterit teknik që lançon një program për studentët. Ne kemi vlerësuar se nuk kategorizohet tek ato aktivitete që duhet raportuar te ndërfaqja e KQZ-së. Në këto kushte, vlerësojmë se nuk jemi në rrethana të shkeljes së detyrimeve të vendimit nr. 9, 14.12.2020 dhe vendimit 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator.

**Z. I. Celibashi:** Kush ka qenë pjesëmarrës aty? Cila ka qenë kategoria e pjesëmarrësve, jo emra, po çfarë kategorie pjesëmarrësish kanë qenë?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Pjesëmarrës kanë qenë nga Autoriteti Portual Durrës, nga universiteti, nga shoqëria civile, Agjensia Kombëtare e punësimit, ka qenë drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, institucion që ushtron veprimtarinë në fushën detare. Gjithashtu dhe nga Bashkia Durrës ka qenë zonja Sako si përfaqësuese e bashkisë. Ashtu sikurse e kemi shpjeguar dhe me shkrim ka qenë në rolin për t'u informuar me iniciativat e Portit Durrës si një institucion që vepron në atë qytet.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Dhe një pyetje ndoshta të fundit nga ana ime. Ka pasur një planifikim për zhvillimin e këtij aktiviteti ditë para, apo dhe ndoshta një program se si do të zhvillohej, pjesëmarrësit, e të tjera si këto?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Qendra e Trajnimeve e kishte planifikuar si lançim të programit të thirrjes së studentëve për ushtrimin e praktikave në Portin e Durrësit, duke e lidhur këtë me sezonin e parë universitar që përkon në muajt janar, shkurt. Në këtë frymë është përcaktuar në këtë periudhë dhe data e lançimit, me mbylljen e sezonit të parë akademik të universitetit.


**Z. I. Celibashi:** Ka një rast tjetër të ngjashëm të zhvillimit të një aktiviteti të kësaj natyre nga ana e Autoritetit Portual Durrës, ose ndoshta dhe vetë Autoriteti Portual Durrës nuk ka qenë organizator, por pjesëmarrës në dijeninë tuaj? Më parë, më pas?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Me këtë natyrë, pra të programit të praktikave të studentëve nuk ka pas. Edhe marrëveshja mes universitetit – portit – agjensisë së punësimit daton në vitin 2021. Për shkak të kohës... ky partneritet nuk kishte shumë kohë përpara që t'i referohemi praktikave të ngjashme.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Përfaqësuesit e Qëndresës, kanë ndonjë pyetje?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Në fakt po! Kam disa pyetje për palët, pasi në përgjigjet e tyre disa gjëra mbetën të paqarta. Në e-mail që i është dërguar zonjës Sako thuhet se është një aktivitet i mbështetur financiarisht, por nuk është e qartë që për këtë aktivitet ku buron mbështetja financiare.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Kemi ndonjë përgjigje për këtë?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Patjetër! Vetë programi konsiston në thithjen e studentëve ekselentë për ushtrimin e praktikës pranë Autoritetit Portual Durrës. Nëpërmjet Agjensisë së Punësimit është dakordësuar që studentët përveç se ushtrojnë praktikë profesionale, marrin dhe një pagesë minimale nga ana e Autoritetit Portual Durrës, për kohën që janë të angazhuar për këtë praktikë profesionale.

**Z. I. Celibashi:** Po, pyetja tjetër ju lutem?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Pra, siç e tha zotëria, nga ana e Autoritetit Portual Durrës, sa kam parë nga përgjigjet, vetë Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare është e themeluar nga Autoriteti Portual Durrës. Kjo qendër ka një personalitet juridik të veçantë apo është në varësi të Autoritetit Portual, sepse nga të dhënat nuk është e qartë se kush është organizatori i aktivitetit.

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Qendra e Ekselencës nuk ka një personalitet të veçantë juridik nga Autoriteti Portual Durrës, por ka marrë këtë emër nga partneriteti i krijuar ndërmjet universitetit dhe palët e tjera pjesë të marrëveshjes.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Pra, përgjegjëse në këtë rast për raportimin do të ishte vetë Autoriteti Portual Durrës. Po ashtu një pyetje të fundit, thuhet gjithashtu nga përgjigjet e kthyera nga institucionet që kjo thirrje vjen në kuadër të një plani vjetor. Pse nuk ka qenë e mundur që ky plan vjetor të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

vihej në dispozicion të palëve, për të parë kështu nëse ishte planifikuar më parë, apo përshpejtuar hapja e kësaj thirrje?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Nuk ka pas një plan të mirëfilltë vjetor me data të përcaktuara. Thjesht ka pasur një prioritet të CEMA-s, ku një ndër to ka qenë shpallja për studentët që do të përkonte me mbarimin siç e thashë dhe më parë të sezonit të parë akademik në universitet.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Ju gjithashtu pohoni se karakteri i këtij aktiviteti është një karakter informues?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Atëherë, edhe në shkresë kemi cituar, por dhe këtu theksova që takimi ka qenë mes partnerëve të CEMA-s, pra të universitetit – autoritetit., janë ftuar dhe institucione të tjera që do të kontribuonin në praktikat ku do të operonin studentët.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Për të informuar pjesëmarrësit

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Pjesëmarrësit, partnerët? Partnerët vendosin! Nuk është se Autoriteti Portual Durrës do të informonte universitetin, apo Institutin për Bashkëpunim e Zhvillim, por thjesht do të diskutohej dhe dakordësohej procesi.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Siç e thashë dhe pak më parë, pjesëmarrja ka qenë e gjerë dhe në këtë aktivitet kanë qenë edhe studentë pjesëmarrës. A ka qenë synimi i këtij aktiviteti informimi i studentëve?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Studentët dhe masa e gjerë është realizuar nëpërmjet njoftimit në faqen zyrtare që është kjo shpallje dhe mund të merrni pjesë me aplikimet tuaja, jo ky aktivitet në vetvehte ka pas karakter informues.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Pyetje të tjera nuk kemi?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Mirë! Përpara se ta konsideroj të mbyllur si hetim, por jo si shqyrtim, kemi kërkesë për dokumentacion tjetër që ju keni nevojë për të mbështetur pretendimet tuaja, ose nëse Autoriteti Portual Durrës sheh interes për të depozituar dokumentacion tjetër shtesë, ose ndonjë deklaram?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Ndoshta do të ishte i dobishëm depozitimi i planit vjetor, për aq kohë sa ata deklarojnë që ka një plan vjetor që rakordohet.

**Z. I. Celibashi:** E kërkoni këtë?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Mund ta kemi këtë, mund ta sillni?

**Z. A. Marku, përfaqësues i Autoritetit Portual Durrës:** Patjetër! Do të kthehem në institucion dhe do t'ua përcjellim.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Kërkesë tjetër edhe për të kursyer kohë, në qoftë se keni nevojë?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** I qëndrojmë kërtimeve tona!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! E pranojmë kërkesën e Qëndresës për të prezantuar nga Autoriteti Portual Durrës dhe dokumentin e kërkuar. Për sot seancën e mbyllim dhe do t'u njoftojmë, por kjo varet edhe nga koha kur ju do të depozitoni këtë dokumentacion dhe ne t'ia bëjmë të ditur organizatës. Dakord, mbyllim seancën për këtë pikë të rendit të ditës!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

13.04.2022  
Ora 13:12

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath”, kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Durrës, zonja Emiriana Sako, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”.*

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**

• **Parti Politike:** **S’ka**

• **OJQ** **KRIK**

• **Të tjerë:**

1. Organizata Qëndresa Qytetare: **Znj. T. Kurti, R. Xhemollari**

2. Drejtor i Shkollës 9-vjeçare

“Armath”, Durrës **Z. V. Doda**

3. Bashkia Durrës **Z. A. Isaku**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit po të Organizatës Qëndresa Qytetare, në lidhje me shkelje të pretenduara nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Armath” dhe kandidati për kryetar të Bashkisë Durrës, mbështetur nga Partia Socialiste.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*


Atëherë, përfaqësuesit e Qëndresës janë prezent. Përfaqësues nga Bashkia Durrës, janë prezent. Shkolla 9-vjeçare, drejtori? Po! Ju lutem emër, mbiemër dhe një dokument identifikimi keni me vete? Dakord! Mund të afroresh të lutem te mikrofon.

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Jam Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”.

**Z. I. Celibashi:** Hapim seancën për shqyrtimin e kësaj çështjeje, i japim fjalën përfaqësuesit të Organizatës Qëndresa Qytetare për të prezantuar shkeljet që janë konstatuar sipas tyre nga ana e drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath” dhe kandidates për kryetare të Bashkisë Durrës, mbështetur nga Partia Socialiste në kuadër të zgjedhjeve të 6 marsit. Po fjala për ju!

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Faleminderit i nderuar! Në denoncimin e Qëndresës Qytetare është bërë e ditur raportimi i një aktiviteti elektorale të zonjës Sako i cili është mbajtur për sa shihet nga pamjet në ambjentet e jashtëme të Shkollës 9-vjeçare “Armath”. Në referim të të gjitha provave dhe fakteve, por edhe në referim të përgjigjeve që na kanë kthyer institucionet palë të këtij procesi, ajo ç’ka vihet re në këtë rast është se Bashkia Durrës shprehimisht thotë që “Denoncimi i subjektit Qëndresa Qytetare nuk është plotësisht i saktë”. Ndër të tjera shprehet se takimi është zhvilluar në sheshin pranë shkollës dhe nuk ka penguar mbarëvajtjen e veprimtarisë. Nga ana tjetër në shkresën e përcjellë nga drejtori i shkollës, pranohet në një farë mënyre të jetë zhvilluar ky aktivitet dhe thuhet se takimi është zhvilluar në datën 25.02.2022 në orën 17:00 përtej orarit mësimor dhe pa pjesëmarrjen e nxënësve. Duke pranuar në një farë mënyre që ky

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

takim është zhvilluar në ambjentet e jashtëme të këtij institucioni mësimor, ç'ka çon shprehimisht në shkelje të nenit 91 për përdorim të burimeve shtetërore në zgjedhje. Faktet për këtë rast janë edhe më të qarta. Ne gjithashtu kemi depozituar prapësimet tona më parë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk është parë e arësyeshme të shtohet asgjë tjetër.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! I japim fjalën drejtorit të shkollës dhe pastaj përfaqësuesit të Bashkisë Durrës. I nderuar zoti Drejtor, ju jeni njohur me pretendimet e organizatës?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Kush është mendimi dhe opinionimi juaj në lidhje me këto pretendime?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Ky takim është zhvilluar në orën 17:30 përtej orarit mësimor plotësisht. Është zhvilluar jashtë ambjenteve të shkollës në një kohë kur aty janë zhvilluar edhe veprimtari të tjera si shkollë komunitare që ne jemi. Gjithshka është zhvilluar jashtë ambjentit të shkollës.

**Z. I. Celibashi:** Jashtë ambjentit të shkollës?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Jashtë ambjentit të shkollës edhe oborrit rrethues? Pretendimi i organizatës është që është zhvilluar në ambjentet e shkollës jo në kuptimin e godinës, por të oborrit të shkollës, të territorit.

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Jo në oborrin e shkollës, por jashtë në pjesën ku ka hapësira, jashtë oborrit të shkollës është zhvilluar takimi.

**Z. I. Celibashi:** Nuk është pjesë e shkollës ambjenti ku është zhvilluar takimi?


**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Jo është një ambjent i lirë aty, por jo i shkollës. Ka qenë një moment kur takimi ishte parashikuar të zhvillohej diku tjetër, por për arsye të kushteve atmosferike, na është kërkuar nga ana e njësisë vendore që aty afër të zhvillohet një takim dhe kështu është bërë.

**Z. I. Celibashi:** Kemi ndonjë gjë tjetër për të thënë në lidhje me këtë, i nderuar Drejtor?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Kaq kisha unë për të thënë.

**Z. I. Celibashi:** Po në këtë aktivitet, në këtë ambjent që ju thoni që nuk është ambjent i shkollës, nuk ka lidhje me shkollën, për gjithë pjesën tjetër të pretendimeve jeni dakord? Pra, çfarë pretendojnë përfaqësuesit e organizatës qëndrojnë? Në lidhje me pjesëmarrjen etj., etj.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*


**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Në lidhje me pjesëmarrjen, orarin po! Desha të theksoj dhe njëherë që ka qenë një takim pa pjesëmarrjen e nxënësve, jashtë procesit mësimor, kjo është e sigurtë.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Mundem?!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! I japim fjalën dhe përfaqësuesit të bashkisë dhe pastaj në qoftë se do të keni pyetje për të sqaruar, po pa komente. Pastaj do të jeni në të drejtën tuaj edhe për të komentuar.

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Faleminderit i nderuar! Ashtu siç e kemi paraqitur dhe në prapësimet tona, Bashkia Durrës ka bërë raportimin me datë 21.02.2022 lidhur me takimin që do të organizohej në Fshatin Armath. Nga organizatorët e takimit më është referuar që në kushtet kur në vendin e caktuar, si pasojë e një kohe jo të qëndrueshme nuk ishte e mundur të organizohej takimi në atë vend. Në kushte emergjente është spostuar në afërsi të shkollës. Ndër të tjera i nderuar, doja të citoja dhe faktin që në këto takime janë trajtuar problematika e rindërtimit që lidhet me emergjencën dhe vazhdueshmërinë e një procesi i cili varet nga ndërthurja e punës dhe aktivitetit të një sërë instuticionesh dhe jo vetëm të Bashkisë Durrës. Pretendimi ynë është se ky aktivitet nuk është në kundërshtimet e pretenduara, në kundërshtim të nenit 91 të kodit dhe të vendimit nr. 9. Për më tepër edhe në qoftë se do të ishte, duhet të merret për bazë që ky aktivitet realisht është bërë në afërsi të shkollës, por jo në ambjentet dhe oborrin e shkollës. Duke qenë i tillë edhe sikur pretendimi të merret i mirëqenë, është bërë në një orar që nuk cënon aktivitetin e shkollës. Shkolla “Armath” ka një status të shkollës qendër komunitare, ku përfaqësuesit e njësisë së qeverisjes vendore marrin pjesë, kjo është!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Pyetje nga përfaqësuesit e Qëndresës, për të sqaruar ndonjë moment që për ju mund të mos jetë shumë i qartë.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Për sa tha edhe drejtori i shkollës, por edhe përfaqësuesi i bashkisë, u tha që prej kushteve atmosferike u bë zhvendosja e aktivitetit. Zoti Doda tha që jemi komunikuar nga njësia vendore. Kush konkretisht ju ka komunikuar nga njësia vendore për zhvendosjen dhe kushtet e kësaj zhvendosje?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Kryetari i njësisë vendore.

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Nëpërmjet një dokumenti?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Jo! Me një bisedë telefonike. Më është thënë që është marrë një leje se do të zhvillohet një veprimtari aty afër dhe kaq!

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Në se mundem në replikë edhe të përfaqësuesit të Bashkisë Durrë që tha “shkolla është dhe në funksion të aktiviteteve të qendrës komunitare”. Ky nuk është një aktivitet në funksion të shkollës si qendër komunitare, se në këtë aktivitet kemi elementë elektorale. Kemi banera që tregojnë që po zhvillohet një aktivitet elektorale dhe fotot tregojnë që ky aktivitet po mbahet pranë fushave sportive të kësaj shkolle. Po ashtu do të shtoja diçka, nëse mundem, për raportimin e këtij aktiviteti, i cili pranohet nga vetë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

përgjigjet tuaja se nuk ka qenë i plotë për shkak të kushteve të cilat nuk e provojnë këtë fakt. Nuk ka qenë i plotë dhe sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Pyetje tjetër nuk kemi, faleminderit! Po!

**Z. R. Xhemollari, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Atëherë, një pyetje plotësuese, një pyetje logjike që lind nga e gjithë kjo. Në qoftë se pretendohet që shkolla, ose ambjenti nuk është në pronësi të shkollës, pse është marrë leje nga njësia e qeverisjes vendore, kur ambjenti nuk është në pronësi të shkollës? Kjo më shumë për të qartësuar çështjen.

**Z. I. Celibashi:** Drejtor, keni ndonjë përgjigje për këtë?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Në lidhje me zhvillimin e mësimit, me orarin mësimor, në mënyrë që të mos binte ndesh me orarin mësimor një veprimtari e tillë.

**Z. R. Xhemollari, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Në orën 17:00?

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Po po, se janë dy orare. Mësimi zhvillohet me turne në Shkollën 9-vjeçare “Armath”. Janë dy shkolla, njëra e fillon mësimin në orën 13:00 pasdreke.

**Z. R. Xhemollari, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Po tjetra?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Tjetra në orën 8:00 të mëngjesit. Pra, janë dy shkolla. Njëra është pasdreke dhe kjo do të thotë që ky orari i 17:30 mund të qëllojë dhe orari mësimor i shkollës së turnit të dytë. Jemi njoftuar që të mos ketë nxënës.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit drejtor! Kemi kërkesa për dokumentacion shtesë që duhet të sjellin qoftë shkolla, qoftë bashkia?

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Nuk shihet e arësyeshme kërkesa për dokumentacion shtesë.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Nga ana juaj?

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Jo!

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Atëherë e konsiderojmë të përfunduar hetimin administrativ. Para se ta përfundojmë dhe shqyrtimin në tërësi fjala e fundit për ju, përfaqësues të Qëndresës. I qëndroni pretendimeve? E pastaj për secilën nga palët. Shkurt ju lutem!

**Znj. T. Kurti, përfaqësuese e Organizatës Qëndresa Qytetare:** Për sa u parashtrua edhe më parë, ne në përfundim kërkojmë konstatimin e shkeljes nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 13.04.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po i drejtori shkollës, përfundimisht! Pretendimet që ngre Qëndresa për ju?!

**Z. Vlash Doda, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës:** Mendoj se pretendimet që ngrihen nuk janë plotësisht të drejta. Aty është zhvilluar një takim elektorale, por jo në ambjentet e brendshme të shkollës, vetëm këtë kisha për të shtuar!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i bashkisë!

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Ne i qëndrojmë prapësimeve tona duke pretenduar që denoncimi është bërë në kundërshtim me.. pra nuk është shkelur ligji dhe as vendimi përkatës që pretendohet. Aktiviteti siç e thamë, marr shkas dhe nga komunikimi që bëri zonja, përfaqësuese e Qëndresës, që i referohet shkollës, qendër komunitare, ne si pjesë e bashkisë përmendëm shkollën komunitare në kuptimin në qoftë se do të merret për bazë në qoftë se kjo është bërë në të. Realisht aty nuk është bërë takimi në ambjentet e shkollës, është bërë në afërsi të ambjenteve të shkollës. E kemi thënë edhe në prapësime, por siç e thamë dhe këtu, kanë qenë kushtet atmosferike të dy ditëve më parë në Fshatin Armath që na kanë kushtëzuar ne në spostimin e këtij takimi në afërsi të shkollës, sepse nuk ka vend tjetër, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, i japim fund shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje dhe vendimin do ta shpallim një ditë nga java tjetër. Do të njoftoheni, për t'i bërë ndoshta në një ditë të gjitha shpalljet e vendimeve. Falenderoj të gjitha palët për angazhimin serioz dhe debatin e zhvilluar këtu. Ditë të mbarë! Seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

